



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 47
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II.
Prishtinë, më 30 dhjetor 2016, në orën 21:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Nehat Baftiu, Hatim Baxhaku, Fikrim Damka, Fadil Beka, Mirjeta Kalludra.

Munguan: Besa Baftiu, Ali Berisha, Adem Hoxha dhe Shukrije Bytyçi.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Nehat Baftiu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L -261, për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;
3. Të ndryshme.

Kryetari i Komisionit, Nehat Baftiu, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L -261, për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Kryetari theksoi se si Komisioni raportin me amendamente e kemi përcjellë te katër komisionet e përhershme, ku nga tri komisionet e përhershme kemi pranuar raportet nga të cilat nuk kemi pranuar asnjë vërejtje lidhur me amendamentet tona. Kurse nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, nuk kemi pranuar raport lidhur me projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-261, për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Te amendamenti 7 kemi dy propozime të ndryshme për të njëjtin nen, propozojmë që të ndahet në dy amendamente si amendament 7 dhe 8, për shkaqe teknike.

Komisioni njëzëri vendosi që amendamenti 7, të ndahet në dy amendamente për shkaqe teknike.

Komisioni, pas diskutimit, njëzëri miratoi raportin përfundimtar dhe komisioni nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-261, për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe i njëjti procedohet për miratim në seancë;
2. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, rekomandon që të autorizohet drejtoria për standardizim, përafrim dhe harmonizim ligjor të bëjë harmonizimin e tekstit në gjuhën serbe dhe angleze me tekstin e gjuhës shqipe.

3. Të ndryshme

Kryetari – A ka dikush të shtojë diçka të kjo pikë? Jo. Atëherë e mbylлим mbledhjen dhe ju falënderoj për kontributin tuaj.

Mbledhja përfundoi në orën 21:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Nehat Baftiu